



**RAPORT I MONITORIMIT
QEVERISJA LOKALE NË FERIZAJ
KAÇANIK , SHTIME, HANI I ELEZIT
Janar -Qershor 2011**

Ferizaj, Gusht 2011

Tabela e përmbajtjes:

Hyrje.....	1
Metodologjia.....	2
Komuna Ferizaj.....	3
Kryetari i Komunës.....	3
Marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe qytetarë.....	3
Llogaridhënia dhe marrëdhënia me asamblenë komunale.....	4
Qasja në dokumente zyrtare të kryetarit të komunës.....	5
Përgjegjësitë tjera të kryetarit të komunës.....	5
Realizimi i premtimeve të kryetarit.....	6
Kuvendi i Komunës.....	9
Shëndetësia.....	11
Arsimi.....	12
Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë.....	13
Problemet me të cilat përballet komuna dhe qytetarët.....	14
Komuna Kaçanik.....	16
Komuna Kaçanik.....	16
Kryetari i Komunës.....	16
Realizimi i premtimeve të kryetarit.....	17
Kuvendi i Komunës.....	18
Arsimi.....	19
Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë.....	20
Problemet me të cilat përballet komuna dhe qytetarët.....	20
Komuna Shtime.....	23
Komuna Shtime.....	23
Kryetari i Komunës.....	23
Realizimi i premtimeve të kryetarit.....	24
Kuvendi i Komunës.....	25
Arsimi.....	27
Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë.....	27
Problemet me të cilat përballet komuna.....	28
Komuna Hani i Elezit.....	29
Komuna e Hanit të Elezit.....	29
Kryetari i Komunës.....	29
Kuvendi i Komunës.....	31
Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura.....	32
Arsimi.....	32
Shëndetsia.....	32
Rreth Inpo-s.....	33

Një prej parimeve themelore të organizimit të institucioneve shtetërore në Kosovë dhe të strukturës së saj ligjore është parimi i subsidiaritetit¹. Sipas këtij parimi vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër atyre. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më efikase dhe të kenë mekanizma të përshtatshëm për të kontrolluar dhe për të kërkuar përgjegjësi nga organet vendim-marrëse. Nisur nga qëllimet e këtij parimi, qeverisjes lokale në Kosovë i është kushtuar vëmendje e madhe dhe organeve komunale si bartëse.

Organet e vetëqeverisjes lokale, Asambleja dhe Kryetari i Komunës, zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejt nga votat e qytetarëve. Në bazë të strukturës ligjore në Kosovë, Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komunave u njihen kompetenca të gjëra në shumë fusha. Andaj, ato janë adresa ku qytetarët duhet të kërkojnë përgjegjësi për fusha si zhvillimi ekonomik lokal, arsimiti, shëndetësia, punësimi, rregullimi urban, kushtet për të zhvilluar biznes etj.

Me gjithë këtë rol me rëndësi të Komunës, në Kosovë ballafaqohemi me disa probleme sa i përket ushtrimit të përgjegjësisë dhe detyrave të tyre. Komunat mbesin përgjithësisht të mbyllura për kontroll nga qytetarët dhe shoqëria civile por edhe qasja në informata dhe dokumente zyrtare mbetet shumë e vështirë. Problem i madh mbetet komunikimi direkt me qytetarë dhe orientimi i qeverisjes bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Kjo mungesë komunikimi ka ndikuar që agjenda e tyre të mos reflektojë projekte dhe investime në fushat e kërkuara nga qytetarët. Në këtë mënyrë, qeverisja lokale në Kosovë nuk është duke funksionuar sipas standardeve të kërkuara për vetëqeverisje lokale dhe parimeve kryesore të qeverisjes demokratike.

INPO me qëllim të adresimit të kësaj problematike, në bashkëpunim me The National Endowment for Democracy (NED) kanë lansuar projektin “Promovim i komunikimit kualitativ mes qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur”. Përmes projektit synohet të arrihen këto objektiva:

1. Promovimi i Transparencës dhe llogari-dhënies
2. Përmirësimi i komunikimit kualitativ në mes institucioneve publike
3. Përfshirja e nevojave të qytetarëve në agjendat e zyrtarëve të zgjedhur

¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli X
Ligji për Vetë- Qeverisje Lokale, neni 15

Metodologjia

Në kuadër të projektit “Promovimi i komunikimit kualitativë mes qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur” dhe për realizimin e objektivave të projektit janë të parapara aktivitete të ndryshme për tu implementuar nga INPO. Këto aktivitete përmblihen në aktivitete për promovimin komunikimit, dhe llogaridhënies Komunë-qytetarë dhe monitorimin e drejtpërdrejt të punës së organeve Komunale, ku përfshihet Ekzekutivi, i cili udhëhiqet nga Kryetari i Komunës dhe Asambleja Komunale e Komitet e saj. Për realizimin e këtyre qëllimeve janë të angazhuar monitorues, detyra e të cilëve është monitorimi i realizimit të premtimeve, arritjes së objektivave dhe efikasitetit të punës dhe kjo në kuadër të parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies.

Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti përfshin elemente të hulumtimit cilësor, sasior dhe krahasues. Hulumtimi cilësor përfshin analizimin e legjislacionit në fuqi mbi vetëqeverisjen Lokale dhe Statutet e Komunës të cilat e ngarkojnë Komunën me përgjegjësi dhe detyra të caktuara. Në aspektin sasior përfshihen anketat e ndryshme të realizuara me qytetarë të cilat masin perceptimin e tyre mbi kënaqshmërinë e tyre në lidhje me punët e Komunave. Hulumtimi krahasues ka dy dimensione, krahasimin me standardet e pranuar ndërkombëtare mbi vetëqeverisjen lokale dhe krahasimin e punës mes Komunave të cilat janë nën monitorim, Ferizaj, Kaçanik, Han i Elezit dhe Shtime.

Burimet e të dhënave për përpilimin e këtij raporti përfshijnë raportet e monitorimit të INPO të përgatitura nga monitoruesit në terren, tryezat e organizuara nga INPO gjatë implementimit të projektit, analizë të dokumenteve dhe shkresave zyrtare të organeve Komunale. Si burim i dytë janë përdorur raportet e punës të organeve komunale dhe raportimet e medieeve.

Ky raport i monitorimit të qeverisjes lokale përfshin Komunitat e Ferizajt, Shtimes, Hanit të Elezit dhe Kaçanikut. Periudha kohore për të cilën raportohet përfshin periudhën Janar-Qershor 2011.

Komuna Ferizaj

Komuna e Ferizajt është njësi administrative në pjesën jugore të pjesës qendrore të Kosovës me qendër në Ferizaj. Komuna e Ferizajt është një udhëkryq i rëndësishëm, nëpër të cilin kalojnë rrugët kryesore lindje-perëndim dhe veri-jug. Nëpër këtë qytet kalojnë rrugët kryesore magjistrale që shkojnë edhe jashtë Kosovës. Ferizaj është një qytet relativisht i ri. Ka filluar të zhvillohet prej vitit 1873, kur këtu u ndërtua hekurudha dhe stacioni hekurudhor².

Kryetari i Komunës

Organi i Kryetarit të Komunës është një prej posteve më të rëndësishme në Komunë. Zgjedhja e kryetarit bëhet nga vota e lirë e qytetarëve dhe si i tillë paraqitet bartës i pushtetit ekzekutiv. Ky post në Komunën e Ferizajt ushtrohet nga Bajrush Xhemali, i zgjedhur në zgjedhjet e fundit lokale në Kosovë në Nëntor 2009.

Qeverisja e z. Bajrush Xhemali në Komunën e Ferizajt në periudhën Janar – Qershor 2011 cilësohet me shumë probleme dhe shkelje ligjore. Kryetari vazhdon mos bashkëpunim me shoqërinë civile dhe qytetarët, shkelje të ligjit lidhur kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare, mungesë llogaridhënies dhe mos realizim i premtimeve të bëra gjatë fushatës.

Marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe qytetarë

Kryetari i Komunës vazhdon të jetë tërësisht i mbyllur ndaj INPO-s si një ndër organizatat lidere të shoqërisë civile në qytetin e Ferizajt. INPO ka bërë përpjekje të shumta për takime dhe bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, e të cilat janë refuzuar pa arsye të mirëfillta. Organizata INPO rikujton Kryetarin se qysh prej mandatit të parë të tij kishte pasur raporte konstruktive me atë, duke dhënë kontribut të çmuar për forcimin e demokracisë dhe parimeve të transparencës në punën e komunës së Ferizajt dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve të Ferizajt.

Arsyetimi dhe akuzat e tij janë se INPO e ka shpallur atë persona non-grata, kur gjatë zgjedhjeve të 2009, INPO publikoi Raportin me të dhëna nga hulumtimi i Biografive të kandidatëve për poste publike, në të cilin Kryetari Xhemajli së bashku me 9 persona të tjerë të partive të ndryshme është evidentuar në listën e personave të cilët ishin përballur dhe kishin probleme me ligjet e Republikës së Kosovës dhe si të tillë nuk meritonin votën e qytetarëve të Ferizajt për të qeverisur me qytetin e Ferizajt.

²Komuna e Ferizajt, sajti zyrtarë, i disponueshëm në: <http://kk.rks-gov.net/ferizaj/Assembly-1.aspx>

INPO i rikujton Kryetarit se qëndrimi i tij ndaj INPO-s është i pajustificueshëm për dy arsye, natyrës së publikimit në fjalë dhe funksionit të cilin e ka. Publikimi i biografive dhe personave të cilët kishin probleme me ligjin është i bazuar në të dhëna faktike të vërteta³. Kryetari do të mund të reagojë nëse informatat e paraqitura do të ishin shpifje por jo edhe për shkak të identifikimi dhe njoftimit të qytetarëve lidhur me probleme e tij me ligjin. Për më tepër nuk është kompetencë e INPO-s të shpallë persona non-grata pasi ky është nocion i drejtës publike dhe është vetëm kompetencë e institucioneve publike. E tërë puna e INPO-s ka qenë evidencimi i kandidatëve të cilët ballafaqoheshin me shkelje të ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Në anën tjetër, pozita e Kryetarit të Komunës nuk lidhet me personin e caktuar por është institucion i cili përfaqëson vullnetin e qytetarëve. Në këtë mënyrë, është e ndalshme përdorimi i pozitës së tillë për interesa apo inate personale. Pa marrë parasysh se cili është mendimi i Kryetarit për INPO-n ai është nën detyrë ligjore që të bashkëpunojë dhe të takohet me qytetarët dhe OJQ-ët e interesuar lidhur me punën e Komunës.

INPO gjatë procesit të monitorimit të punës ka vërejtur se Kryetari nuk e ka përmbushur në mënyrë të rregullt as obligimin e tij ligjor të takimit të qytetarëve. Monitoruesit kanë qenë dëshmitar se në ditën e caktuar për qytetarë në shumicën e kohës nuk ka qenë prezent kryetari dhe as nënkryetari por edhe as asistentja e tij, ndërsa qytetarët kanë pritur me orë të tëra para zyrës me shpresën se do ti takojnë ata.

Llogaridhënia dhe marrëdhënia me Asamblenë Komunale

INPO shpreh shqetësimin e saj se edhe sa i përket llogaridhënies nga ana e Kryetarit të Komunës, ka pengesa serioze, kjo në raport me Kuvendin e Komunës. INPO gjatë monitorimit të punës së këtyre dy organeve komunale ka vërejtur se Kryetari nuk i ka kushtuar vëmendjen e nevojshme Kuvendit Komunal dhe po ashtu raportet e punës të paraqitura kanë qenë jo-profesionale dhe nuk kanë pasqyruar zhvillimet e vërteta në Komunë.

Bazuar në të dhënat e monitoruesve, mbledhjet e Kuvendit të Komunës nuk kanë pasur peshë të madhe për kryetarin Xhemaili, ku gjatë katër muajve të parë vetëm një herë ka marrë pjesë në seancë të kuvendit të komunës, dhe atë në seancën ku u diskutua raporti një vjetor i punës së kryetarit. Në anën tjetër INPO ka analizuar edhe angazhimin e tij në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Kryetari Xhemaili ka organizuar tri mbledhje të këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjatë këtyre tri mbledhjeve është përpiluar dhe miratuar plani i veprimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Mirëpo ky plan i veprimit ka mbetur vetëm në letër, cka do të thotë se nuk po gjen zbatueshmëri në praktikë. Cështjet që ngriten nga ky këshill shpesh herë mbeten në nivel diskutimi dhe nuk merren seriozisht, duke krijuar përshtypjen se Këshilli për Siguri në Bashkësi funksionon vetëm sa për ta përmbushur një obligim ligjor.

Në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal, kryetari Xhemaili prezantoi para këshilltarëve raportin vjetor të punës së tij. Në përgjithësi në raport ka vetëm një përmbledhje të dhënave në formë tabelave apo paragrafëve që janë të shkurtra e që janë thjeshtë raportim teknik. Raporti është

³Aksidenti të cilin e kishte shkaktuar ku me veturë ku kishte pasur viktimë, *shih: infra note 5*

vetë lavdërues dhe nuk tregojnë problemet dhe sfidat që ekzekutivi është ballafaquar gjatë këtij viti të mandatit të Kryetarit z. Bajrush Xhemali. Pjesa më e rëndësishme, pse ky raport është jo real është për shkak se nuk bazohet në “strategjinë” që kishte prezantuar Kryetari në fillim të mandatit të tij, e cila strategji kishte marrë shumë kritika. Në këtë raport nuk tregohet se sa janë përmbushur objektivat e kësaj strategjie. Ky raport nuk specifikon edhe as një objektiv nga strategjia, dhe fare nuk e tregon nivelin se sa është zhvilluar Komuna e Ferizajt.⁴ *E gjithë puna e Kryetarit të Komunës paraqitet vetëm në 4 faqe, prej gjithsej 195 sa ka ky raport. Edhe tek përshkrimi i punës së Drejtorive INPO ka shumë vërejtje, për arsye se në raport të punës janë përfshirë të dhëna teknike dhe përshkrim i përgjegjësive dhe nuk përmban krahasim të rezultateve me objektivat apo kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.*

Qasje në dokumentet zyrtare të Kryetarit të Komunës

Shqetësuese për INPO-n ka qenë qëndrimi i Kryetarit të Komunës lidhur me kërkesat zyrtare për qasje në dokumentet zyrtare. Edhe me rastin këtyre kërkesave Kryetari keqpërdor pozitën të cilën e ka, në shkelje të ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, duke e injoruar plotësisht kërkesën e INPO-s. Me 21 janar 2011 INPO ka parashtruar një kërkesë të tillë zyrtare në adresë të Kryetarit të Komunës së Ferizajt Bajrush Xhemali, ku ka kërkuar të ketë qasje në planin e punës së kryetarit për vitin 2011.

Në bazë të ligjit për qasje në dokumente zyrtare, nenit 6 respektivisht, institucionet publike janë të obliguara që brenda afatit prej 15 ditësh të lejojnë qasjen në dokumente zyrtare, ose të japin arsyetim në rast të refuzimit. Kryetari i Komunës së Ferizajt z Xhemali, nuk ka ofruar asnjë përgjigje qoftë zyrtare ose verbale për kërkesën e parashtruar të regjistruar më datën 21 janar 2010.

Me këtë veprim kryetari Xhemali ka bërë shkelje të ligjit për qasje në Dokumente Zyrtare të nenit 6 dhe respektivisht 9. Një veprim i tillë bie ndesh me zotimet ose premtimet e kryetarit për respektim të ligjit dhe për më shumë transparencë, llogaridhënie si dhe bashkëpunim me shoqërinë civile.

Përgjegjësitë tjera të Kryetarit të Komunës

Angazhimet tjera të kryetarit të Komunës lidhen me fusha tjera ku sukseset e arritura janë shoqëruar me shkelje të ndryshme dhe shfrytëzim jo-efikas të mjeteve.

INPO i njeh meritat Kryetarit të Komunës lidhur me investimet në infrastrukturë, angazhimet në mbështetje të studentëve ferizajas në Itali dhe ndërtimin e bashkëpunimit me Komuna dhe institucione tjera, ndër to edhe CARITAS, prej të cilave ka përfituar qyteti dhe qytetarët e Ferizajt. Kryetari gjatë kësaj kohe ka pasur edhe shumë vizita jashtë shtetit, rezultat e të cilave nuk janë parë ende, e të cilat kanë ndikuar në përkushtimin e Kryetarit në përmbushje të obligimeve të tij.

Përkundër kësaj, gjatë këtij gjashtë mujori (Janar – Qershor 2011) ka pasur edhe probleme tjera të cilat kanë ndikuar në performancën e Kryetarit. Këtu përfshihet të lënduarit dhe viktimat, të cilët u shkaktojnë si rezultat i aksidentit të kryetarit të komunës e për të cilën u dënua me dy vite e gjysmë burg⁵.

⁴ “Analiza e Raportit të punës së Kryetarit”, Iniciativa për progres, 12 Prill 2011

⁵ “Bajrush Xhemajli dënohet me 2,5 vjet burgim”, Gazeta Zeri, 26 Nëntor 2010, i disponueshëm në: <http://www.zeri.info/artikulli/29/29/13551/bajrush-xhemajli-denohet-me-2-5-vjet-burgim/>

Realizimi i premtimeve të Kryetarit

Kjo pjesë e raportit vlerëson realizimin e premtimeve të Kryetarit të Komunës lidhur me projekte dhe investime të ndryshme. Këto premtime janë përmbledhje e monitoruesve të INPO-s bazuar në deklaratat dhe premtimet publike të dhëna nga kryetari Xhemali, sidomos gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2009.

Premtimet	Vlerësimi
Transparencë dhe komunikim më të madh me qytetarë	3
Shpenzim efikas të fondeve publike	4
Përgjegjshmëri të udhëheqësit e të gjithë sektorëve nën udhëheqjen e tij	3
Investime në vlerë prej 120 milionë euro (premtim i Kryeministrit Hashim Thaçi)	0
Rregullimin e ish-shtëpisë së TMK-së dhe shndërrimin e saj në shtëpi për aktivitete kulturore	4
Mbështetjen për biznesmenët dhe inkurajimin e tyre që të lajmërojnë shantazhet	0
Asfaltimin e të gjitha rrugëve primare dhe sekondare, në fshatra dhe qytet	4
Ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza	0
Rregullimin e "Parkut të Lirisë"	4
Ndërtimin e fushës së futbollit në Komogllavë (gjatë vitit të parë të mandatit)	0
Ndërtimin e një shkolle moderne në fshatin Komogllavë me vlerë rreth 2 mil euro	0

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve

- 0 tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
- 1 tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,
- 2 tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3 tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,
- 4 tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe,
- 5 tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit

Transparencë dhe komunikim më të madh me qytetarët

Transparenca dhe komunikimi në komunën e Ferizajt nuk mund të jetë në nivelet e kënaqshme. (Shih më lartë kapitullin e veçantë mbi Transparencën e Kryetarit të Komunës).

Shpenzim efikas i fondeve publike

Buxheti për vitin 2011 të komunës së Ferizajt është 16, 741, 547.0 euro. Kjo shumë është ndarë në këto kategori ekonomike: Paga dhe mëditje 7,931, 954.0 euro; Mallra dhe shërbime 1, 410, 170,0 euro; Shpenzime komunale 510, 844.0 euro; Subvencione 587,365.0 euro; Investime kapitale 6, 301, 214.0 euro⁶.

Nota e mirë se i është dhënë Komunës në këtë drejtim është si rezultat se kjo ndarje e buxhetit karakterizohet me rritjen e vlerës buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale për 402.309 euro apo 6.4% krahasuar me vitin 2010. Subvencionet kanë shënuar rritje prej 3.14 % , mjete të cilat do të përdoren për realizimin e projekteve kulturore, sportive, si dhe për zbutjen e problemeve sociale për kategoritë e dëshmorëve, invalidëve të luftës si dhe nga kjo kategori do të bëhet ndarja e bursave për student.

Përgjegjshmëri të zyrtarëve të të gjithë sektorëve nën udhëheqjen e tij

Vlerësimi i dhënë për këtë premtim ka marrë si shkas tejkalimi i kompetencave dhe dhënia e vendimeve për shfrytëzim të hapësirave publike për vendosjen e billbordave dhe reklamave ndriçuese pa procedurë tenderuese dhe mos respektim të procedurave ligjore nga Drejtoria e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, është një tregues për përmbushjen e plotë të këtij premtimi. Gjithashtu vazhdimi i ndërtimeve pa leje, uzurpimi i hapësirave publike tregon angazhimin e Drejtorisë së Inspektionit në parandalimin e ndërtimeve të egra dhe uzurpim të hapësirave publike. Zyrtarët komunal nën udhëheqjen e kryetarit jo gjithëherë i qëndrojnë prapa obligimeve dhe përgjegjësisë së tyre.

Investime në vlerë prej 120 mil euro

Ky është një premtim i përbashkët i Kryetarit dhe Kryeministrit të Kosovës z. Hashim Thaqi. Asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

Rregullim i ish shtëpisë së TMK dhe shndërrimin e saj në shtëpi për aktivitete kulturore

Rregullimi i shtëpisë së ish TMK ka përfunduar muaj më parë, dhe ka filluar të funksionoj dhe të përdoret për aktivitete kulturore.

Mbështetjen për biznesmen dhe inkurajimin e tyre që të lajmërojnë shantazhet

Ky premtim i kryetarit Xhemali rezulton të mbetet vetëm shantazhet. Nuk është bërë as edhe një përpjekje për ndalimin e shantazheve ndaj bizneseve.

Asfaltimin e të gjitha rrugëve primare dhe sekondare, në fshatra dhe qytet

Gjatë muajve Janar - Qershor është punuar relativisht mirë. Shkak i vonësve të fillimit të punëve ka qenë edhe vonesa në miratim të buxhetit. Pengesë për realizim ka paraqitur miratimi i Buxhetit të Kosovës, kjo si rezultat i gjendjes politike në nivelin qëndror. Hapa konkretë kanë filluar të merren pas miratimit të buxhetit.

⁶ Buxheti 2011-Projekt propozimi 15.09.2010

Ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza

Që nga fillimi i mandatit të kryetarit e deri më sot, nuk është realizuar ky premtim.

Rregullimin e Parkut të lirisë

Sa i përket parkut të lirisë komuna ka arritur të rregulloj stazat për këmbësor, vendosjen e ulëseve, shportave të mbeturinave, shtyllat elektrike ndriçuese dhe të bëjë pastrimin nga barishtet e egra. Mirëpo, mirëmbajtja e parkut dhe krijimi i kushteve për rekreacion për qytetarë, është punë e cila duhet bërë, për përmbushjen e plotë të këtij premtimi.

Ndërtimin e një shkolle moderne në fshatin Komogllavë me vlerë rreth 2 mil euro

Asgjë nuk është ndërmarr në drejtim të realizimit të këtij premtimi.

Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës përfaqëson organin më të lartë në Komunë dhe përfaqësuesit në Kuvend zgjidhen drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve. Në bazë të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale, numri i përfaqësuesve në Komuna është në varësi të numrit të banorëve. Kuvendi i Komunës ka kompetenca të gjëra dhe përgjegjësi të mëdha. Kuvendi ka në dispozicion mekanizma të shumtë përmes të cilëve mund të ndikojë në performancën e Komunës në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Kuvendi komunal I Ferizaj ka 41 ulëse që plotësohen nga anëtarët e partive politike. Aktualisht në përbërjen e KK Ferizaj kemi këtë ndarje në bazë të votave që kanë arritur të marrin gjatë zgjedhjeve lokale 2009.

Përbërja e Kuvendit

- PDK 15
- LDK 11
- AKR 5
- LDD 3
- AAK 3
- PSK 1
- PD 1
- PDAK 2

Komiteti për politikë dhe financa

AGIM ALIU -KRYESUES
XHAVIT ZARIQI-PDK
LULËZIM GRAINCA- AKR
SAHIT KRASNIQI-LDD
LUËZIM ALIU -PDK
ABDULLAH HOXHA-LDK
KEMAJL RAMADANI-AKR

INPO vlerëson se puna dhe aktivitet e Kuvendit Komunal të Ferizajt gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2011 nuk kanë ndikuar në mënyrë të dukshme në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Gjatë monitorimit të INPO-s është vërejtur se pengesat me të cilat përballet Kuvendi përfshijnë mos-organizimin dhe presionin e nevojshëm nga opozita, dhe neglizhimin nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kuvendi Komunal ka dështuar instaloi një lloj ushtrim kontrolli ndaj aktiviteteve të Komunës dhe shpenzimeve të cilat bëhet, buxhetin të cilave e ka miratuar vetë. Për më tepër Kuvendi nuk ka krijuar mekanizëm se si do kërkohet përgjegjësia nga ana e ekzekutivit. Në anën tjetër kjo ka rezultuar që Kryetari të mos i kushton vëmendje.

Në anën tjetër INPO është e shqetësuar se opozitë nuk është mirë e organizuar në punën e saj në Kuvend dhe nuk ka ide e plan-program të qartë të cilat do ti promovonte me punën në asamble dhe të cilat do ti ofronte si alternativë e programeve të partisë në pushtet. Kjo si shtesë e faktit se opozita nuk ka luajtur një rol aktiv. Shikuar në perspektivën tjetër, as pozita nuk është se ka pasur një strategji se si do ta përdor Kuvendin për arritjen e synimeve të saj dhe një agjendë të çështjeve me rëndësi për të.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, në kompetencë të Kuvendit të Komunës janë nxjerrja e rregulloreve të komunës, rregulloreve të punës dhe akteve tjera të nevojshme brenda fushë veprimtarisë⁷. Aktet e miratuara përfishjnë:

Rregulloret Komunale të miratuara gjatë periudhës Janar - Qershor 2011
Rregullore e tatimit në pronë e miratuar për vitin 2011
Rregullore për ndarjen e bursave për studentë

Vendimet e Kuvendit të Komunës gjatë periudhës Janar - Qershor 2011
Për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2011
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale Nr. 84/27 (ndërtim lapidari)
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale Nr. 1066/3 (ndërtim rruge)
Ridestnim dhe bartjen e mjeteve vetanake në 1 022 626 euro
Për miratimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Ferizajit
Për miratimin e raportit vjetor të punës për vitin 2010
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale Nr.1033/5 dhe 1034/8
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale Nr.735/4
Për destinim e ngastrës kadastrale 180/1
Për dhënien në shfrytëzim të pronës së Komunës
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale 880/3
Për destinim e ngastrës kadastrale 1045/3
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ngastrën kadastrale 517
Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale

⁷Ligji për vetëqeverisje Lokale, neni 12, Kuvendi I Kosovës

Shëndetësia

Në përgjithësi, mbrojtja shëndetësore ofrohet përmes: Mbrojtjes Primare(Mjekësia Familjare), mbrojtja sekondare(Spitali), dhe mbrojtjes terciare(klinikat). Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 17, kujdesi primar shëndetësorë menaxhohet nga komuna të cilat detyrime i realizon përmes mjekësisë familjare. Ndërkaq mbrojtja sekondare dhe ajo terciare menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Në kuadër të mbrojtjes primare shëndetësore hyjnë këto shërbime: (I) shërbimet specialistike; (II) shërbimet stomatologjike; (III) enti i urgjencës. Të gjitha këto shërbime realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).

Gjendja e shëndetësisë në Komunën e Ferizajt nuk është në nivel të kënaqshëm. Ky nivel është si rezultat i mungesave në shërbimet të cilat duhet të ofrohen, mos-respektimi i orarit nga ana e mjekëve, mungesa e barnave esenciale dhe tjera. Edhe qytetarët e Komunës së Ferizajt në anketat e zhvilluara nga INPO-s kanë identifikuar po të njëjtat probleme.

Zyrtarët e INPO-së iu bënë vizitë 14 punkteve shëndetësore në 14 fshatra të punës së Ferizajt. Gjatë fazës së monitorimit, zyrtarë të INPO-s janë takuar me personelin e ambulancave si dhe kanë intervistuar qytetarët e fshatrave për funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre punkteve.

Problemet që ne kemi vërejtur gjatë monitorimit janë: mos respektimi i orarit, mungesa e mjekëve , infermiereve, mungesa e barnave esenciale, mos higjiena në objektet e shëndetësisë, mos funksionimi i laboratorëve , mungesa e shërbimeve stomatologjike, mungesa e ngrohjes si dhe punkti shëndetësor në Talinocv, Mirosal, Bablak dhe Babush janë jofunksional për muaj të tërë.

Për Ferizajn mungesë të madhe paraqet mungesa e shërbimit paramedik. Ky shërbim përfshin rastet kur nevojitet ndërhyrje e shpejtë, si shembull aksidenteve. Përpos ankesave të qytetarëve janë edhe disa raportime të medieeve të cilat tregojnë raste kur ndërhyrja e mjekëve të ndihmës së shpejtë në vendin ku nevojiten mund të marrë deri në gjysmë-ore. Ky paraqet një rast nga i cili qytetarët mund të pësojnë edhe me jetë në rastet të aksidenteve të ndryshme.

Në anën tjetër, çështje për diskutim në Ferizaj paraqet edhe trajtimi i personave të cilët duhet të trajtohen me dializë. Për të adresuar këtë çështje INPO në kuadër të projektit për “ Promovim të Transparencës dhe Llogaridhënies së Institucioneve Publike” organizoi tryezën me temë: “Trajtimi i pacientëve me dializë” në Ferizaj. Këtu morën pjesë udhëheqësit e shëndetësisë nga Ferizaj, Shtimja, Hani i Elezit dhe Kaçaniku.

Diskutimet u fokusuan në gjendjen aktuale e cila mbretëron në rajonet e Ferizajt dhe Komunave ndihmëse, numrin e pacientëve dhe problemet me të cilat përballen ata.

Si e arritur e organizimit të kësaj tryeze është se tash e tutje dy pacientët e Komunës së Hanit të Elezit trajtimin e sëmundjes së tyre do ta kryejnë në Ferizaj. Kjo marrëveshje u arrit në debat pas kërkesës së Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë së Komunës së Hanit të Elezit drejtuar strukturave udhëheqëse të spitalit të Ferizajt dhe në pajtueshmëri nga përfaqësues të komunave tjera shëndetësore.

Arsimi

Në kuadër të drejtorive të Komunës së Ferizajt rol të rëndësishëm luan edhe Drejtoria e Arsimit (DKA), ku kjo drejtori ka në mbikëqyrje të gjitha institucionet arsimore: parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunë. Po ashtu Drejtoria e Arsimit e planifikon dhe koordinon zhvillimin e këtyre niveleve të arsimit në konsultim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë(MASHT).

INPO e vlerëson shumë shqetësuese gjendjen e Arsimit në Komunën e Ferizajt. Kjo për arsye se shkollat në Ferizaj vazhdojnë të mbesin të pasigurta për nxënës dhe se cilësia e nxënësve dhe stafit akademik nuk është në nivelin e dëshiruar.

Marrja e masave për sigurimin e ambientin rrethues, urban apo rural, në të cilën janë të vendosura shkollat, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një ambient të sigurt në oborrin e shkollës. Nëse si organizatë do të referohem në sigurinë e shkollave ngase gjatë monitorimit tonë e kemi vërejtur se niveli i sigurisë nëpër shkolla është shqetësues.

Kështu INPO ka reaguar lidhur me incidentin e ndodhur me 13 prill të këtij viti në hyrje të objektit të shkollës së mesme ekonomike "Faik Konica" në Ferizaj, ku një nxënës tek po dilte në pushim sulmohet me armë të ftohta nga një person i panjohur. Rastet e incidenteve të tilla po mbahen të mbyllura për opinionin, si nga ana e menaxhmentit të shkollës, Drejtorisë së Arsimit dhe Policisë së Kosovës. Izolimi i këtyre rasteve nuk kontribuon në luftimin e kësaj dukurie kaq negative në shkollat e Ferizajt. Për më tepër ky rast nuk është i vetmi, pasi raste të sulmeve me armë të ftohta janë regjistruar në po të njëjtën shkollë pak muaj më parë.

Përpos incidenteve me armë, problem tjetër i arsimit në Ferizaj është edhe mungesa e disiplinës së nxënësve dhe mungesat e shumta të nxënësve nga procesi mësimor. Këto rezultuar edhe me përjashtim të shumë nxënësve nga procesi mësimor, masa të cilat nuk i kontribuojnë as shkollave as re-integrimit dhe përmirësimit të nxënësve delikuent.

Në anën tjetër shumë shqetësuese paraqitet edhe gjendja dhe cilësia e arsimit në komunën e Ferizajt. Rezultatet e testit për maurantët e komunës së Ferizajt kanë pësuar rënie drastike në krahasim me vitet e kaluara. Sipas Komisionit Qendror Shtetëror të maturës në komunën e Ferizajt nga 1809 maurantë të cilët iu nënshtruan këtij provimi vetëm 34.06 % kanë arritur rezultat pozitiv. Kjo përqindje dhe ky sukses kaq i ulët është një indikacion shqetësues për gjendjen e arsimit në Ferizaj.

Në raportin vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj thuhet se arsimit po shënon rezultate dhe është duke u standardizuar, ndërsa matës i punës dhe suksesit është testi i maturës shtetërore. Nëse testi i maturës është matës, atëherë ky test po dëshmon se përkundrazi, arsimit në Ferizaj nuk po shënon rezultate dhe nuk është duke u standardizuar, por në fakt, është duke bërë gjithnjë hapa prapa si në cilësi ashtu dhe zhvillim.

Përpos indikatorëve se cilësia e nxënësve është e dobët, situatë e njëjtë paraqitet edhe sa i përket cilësisë së mësimdhënësve. Inspektorët të cilët kishin inspektuar mësimdhënësit në orë të mësimit konkluduan se disa mësimdhënës as vetë nuk meritojnë nota kaluese⁸. Në këto përfundime erdhën

⁸"Vetë mësuesit nuk marrin nota kaluese", Koha Ditore, 26 Janar 2011, version printuar, faqe 14

pasi monitoruan mësimdhënësit të cilët konceptet të cilat I shpjegonin nuk I kishin as vetë të qarta.⁹ Kjo është shumë shqetësuese për arsye se tregon se mungesa e suksesit të nxënësve është një problem edhe më kompleks dhe ka si shkaktarë ndër të tjerë edhe cilësinë e mësimdhënësve.

Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë

Përpos qasjes jo-konstruktive të Kryetarit të Komunës, INPO gjatë monitorimit ka hasur në praktika jo-transparente dhe jo-llogaridhënëse edhe në raport me organet tjera Komunale. Kështu, janë evidentuar një numër veprimesh të Komunës së Ferizajt të cilat bien ndesh me parimet dhe kërkesat ligjore të qeverisjes së mirë. INPO i konsideron se rastet e shkyçjeve kolektive, dhëniet e lejeve për shfrytëzim pa procedura ligjore dhe mungesa e udhëheqësit të Administratës Komunale paraqesin shkelje të rënda ligjore.

INPO ka reaguar ndaj veprimit të kompanisë rajonale Bifurkacioni në Ferizaj, për të bërë shkyçjen kolektive nga rrjeti i ujësjellësit, banorët e lagjeve Esat Mekuli, dhe Ali Pashë Tepelena. INPO ka kërkuar nga Komuna e Ferizajt që si aksionare e kësaj kompanie të ushtroj presion ndaj menaxhementit të kompanisë që të heqë dorë nga kjo praktik jo ligjore dhe jo humane.

INPO shpreh shqetësimin e saj edhe ndaj praktikave të dhënies së lejeve për shfrytëzim të hapësirave publike nga Drejtorisë së Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit në shkelje të procedurave të parapara ligjore.

Drejtori në fjalë me veprimet e saj i ka tejkualuar kompetencat e veta duke dhënë vendime për lejimin e shfrytëzimit të hapësirës publike për vendosjen e billbordave reklamuese dhe ka bërë shkelje të ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, gjithashtu ka bërë shkelje të ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. Në mënyrë ligjore është e specifikuar se çdo dhënie në shfrytëzim apo me qira duhet marrë miratimi nga Kuvendi Komunal me shumicë votash si dhe të fillohet procedura e tenderimit komform ligjit për prokurim publik të Kosovës.

Zhvillim me pasoja negative në Ferizaj ka qenë mungesa e udhëheqësit të personelit në Administratën Komunale të Ferizajt për disa muaj. Ky post i rëndësishëm komunal ushtrohet nga ushtrues detyre duke tejkualuar afatet e parapara ligjore. Emërimi në një pozitë të tillë, bazuar në nenin 60, të ligjit për Vetë Qeverisja Lokale është kompetencë e Kryetarit të Komunës. Kryetari i Komunës së Ferizajt, ka emëruar një ushtrues detyre, i cili tash e disa muaj është duke ushtruar këtë funksion, gjë që bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht nenin 66.5 ku thuhet se brenda 60 ditësh, Kryetari rekruton udhëheqësin e personelit.

Posti i udhëheqësit të personelit të administratës komunale, është post jopolitik me shumë rëndësi dhe i cili duhet të mbulohet sa më shpejtë.

⁹Ibid.

Problemet me të cilat përballet komuna dhe qytetarët

Problemet e evidentuara nga ana e monitoruesve të INPO-s për Komunën e Ferizajt përfshijnë vetëvrasjet në qytetin e Ferizajt, mungesa e një ambienti të pastër dhe gjelbër, gjendja e Komunitetit REA, dhe të tjera.

Fenomeni i vetëvrasjeve dhe tentativave për vetëvrasje është në rritje e sipër në mbarë vendin por edhe në Ferizaj. Gjatë 10 vjetëve të fundit, në komunën e Ferizajt janë evidentuar 56 raste të vetëvrasjeve dhe 147 tentativë për vetëvrasje. Ky numër i vetëvrasjeve për një popullsi sa të Ferizajt paraqet një problem shqetësues. INPO ka organizuar edhe një tryezë ku janë diskutuar faktorët të cilët kanë ndikuar në këtë numër të lartë dhe mënyra e adresimit të tyre.

Qyteti i Ferizajt ka shumë nevojë për ambiente të gjelbra dhe të pastra. Kjo paraqitet edhe si një prej kërkesave kryesore të qytetarëve. Aktivistët e organizatës INPO, kanë realizuar një aksion pastrimi në parkun e Lirisë dhe u ka bërë thirrje qytetarëve dhe institucioneve që të kujdesemi dhe ta ruajmë këtë pasuri natyrore që ka qyteti jonë.

Komuna e Ferizajt duhet të adresojë edhe jetën e komuniteteve dhe barrierat të cilat ata i hasin në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë. Komuniteti REA ka adresuar çështjet si punësimi, strehimi, arsimit sfida dhe nevojë për ta.

Komuna e Kaçanikut

Komuna Kaçanik

Kaçanikut përfshin pjesën juglindore të Kosovës me sipërfaqe prej 211,13 km², përkatësisht 1,94 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës (10,887 km²). Komuna e Kaçanikut përbëhet prej 31 vendbanimeve, 1 me karakter urban dhe 30 rurale, ndërsa kufizohet me komunat e Vitisë, Ferizajt, Shtërpcës dhe në jug me Hani Elezit dhe IRJ të Maqedonisë.¹⁰

Kaçaniku kryesisht është vend industrial, mirëpo ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, veror, malor dhe transit. Nëpër Kaçanik kalojnë magjistratja Prishtinë – Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë – Selanik, e ndërtuar në vitin 1879, ndërsa fakti tjerët se komuna e ka edhe vendkalimin kufitar në Glloboçicë – e bënë Kaçanikun vend të rëndësishëm dhe strategjik në rrafshin ekonomik, turistik, të bashkëpunimit ndër-kufitar etj.¹¹

Kryetari i Komunës

Kryetari i Komunës së Kaçanikut është z. Xhabir Zharku, i cili është zgjedhur në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale me 13 Dhjetor. Kryetari Zharku udhëheq i vetëm në komunën e Kaçanikut pa bërë koalicion më ndonjë parti tjetër politike.

INPO e vlerëson qeverisjen e Kryetari i Komunës gjatë kësaj periudhe raportuese si një periudhë ku nuk janë promovuar rregullat qeverisjes së mirë, respektimit të ligjit dhe mungesës së përgjegjësisë për veprimet e ndërmarra. Është shumë shqetësues dënimi i kryetarit të Komunës për vepra penale, marrja e vendimeve kundër-ligjore dhe personale, dhe veprime tjera anti-demokratike.

Xhabir Zharku është dënuar me 3 vite burgim për shkak të kërcënimit të viktimave dhe detyrimit tyre të tërhiqen nga një tender të cilin e kanë fituar në mënyrë të rregullt. Tender i cili lidhet me privatizimin e fermës në fshatin Rakë të Ferizajt.¹² Gjetja fajtor për këtë vepër të rëndë penale në vende demokratike do të duhej të ndiqej nga dorëheqje/shkarkim i menjëhershëm nga funksionet publike. Insistimi dhe mbetja e Kryetarit në postin e njëjtë paraqet një prej shkeljeve më të rënda të ligjshmërisë dhe parimeve të qeverisjes së mirë në një shtet.

INPO e vlerëson shumë shqetësuese edhe vendimet arbitrare dhe kundërligjore të Kryetarit të Komunës, vendime të cilat i ndërmerr për inate personale. Një vendim i tillë ka qenë pezullimi i Këshillit Komunal të Sigurisë së Bashkësisë të cilin vendosi ta pezulloj për shkak të problemeve dhe mungesës së bashkëpunimit mes Komunës dhe stacionit të Policisë.

INPO, pas konsultimit të legjislacionit në fuqi, ka ardhur në përfundim se vendimi i Kryetarit Zharku bie ndesh me udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale të Sigurisë në Bashkësi, të Ministrisë

¹⁰ Komuna e Kaçanikut, sajti zyrtarë, i disponueshëm në: <http://kk.rks-gov.net/kacanik/City-guide/History.aspx>

¹¹ Ibid.

¹² Gjykata Qarkut në Prishtinë, aktgjykimi numër P57/10, datë 21 Prill 2011, i disponueshëm në: <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/DCPrishtina/zharku/enacting-clause.pdf>

së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal. Gjithashtu ky veprim i Kryetarit Zharku bie ndesh me mbrojtjen e interesave dhe ofrimin e sigurisë së qytetarëve të Komunës së Kaçanikut.

Pas presionit të shumtë Kryetari i Kaçanikut ka pezulluar vendimin e tij anti-ligjor dhe ka ri-funksionalizuar Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi dhe ri-vendoset bashkëpunimi. Është e pakuptueshme mungesa e përgjegjësisë së Kryetarit të Komunës për veprime të tilla anti-ligjore. Ai nuk ka bartur asnjë pasojë për një veprim të tillë. Kjo është një praktikë shumë e dëmshme për qeverisjen lokale, praktikë e cila ka treguar se mekanizmat e kontrollit dhe përgjegjësisë në Komuna janë jo-funksional.

Në anën tjetër INPO e përshëndet veprimin e Kryetarit i cili ka nënshkruar zotimet në “Posteri i zotimit”, që është një memorandum me USAID, ku merr përsipër që gjatë udhëheqjes me Komunën ai do të bazohet në vlerat më të larta të demokracisë, e të cilat janë transparenca dhe komunikimi me qytetarë, llogaridhënia. Në të njëjtën kohë i bën thirrje që në përputhje me zotimet të cilat i ka dhënë, të marrë përgjegjësinë dhe të japë llogari për të gjitha veprimet e tij të ndërmarra.

Realizimi i premtimeve të Kryetarit

Kjo pjesë e raportit vlerëson realizimin e premtimeve të Kryetarit të Komunës lidhur me projekte dhe investime të ndryshme. Këto premtime janë përmbledhje e monitoruesve të INPO-s bazuar në deklaratat dhe premtimet publike të dhëna nga kryetari Zharku, sidomos gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2009.

Premtimet	Vlerësimi
Shpenzim efikas të fondeve publike	2
Uljen e papunësisë	3
Ndarjen e një buxheti prej 40 mijë euro për sport	3
Vazhdimin e investimeve në infrastrukturën bazike (kanalizime dhe ujësjellës për të gjitha fshatrat dhe lagjet e Kaçanikut)	3
Ndërtimin e një palestere sportive	0
Subvencionimin e bujqësisë	4
Shëndetësi modern	1
Ndërtimin e një shkolle të re fillore në qytet	2
Katërfishimin e investimeve gjatë katër viteve të ardhshme	4

Tabela 2: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.

- 0 tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
- 1 tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,
- 2 tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3 tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,
- 4 tregon se hapa konkret kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe
- 5 Tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.

Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës përfaqëson organin më të lartë në Komunë dhe përfaqësuesit në Kuvend zgjidhen drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve. Në bazë të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale, numri i përfaqësuesve në Komuna është në varësi të numrit të banorëve. Kuvendi i Komunës ka kompetenca të gjëra dhe përgjegjësi të mëdha. Kuvendi ka në dispozicion mekanizma të shumtë përmes të cilëve mund të ndikojë në performancën e Komunës në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Në Kuvendin Komunal të Kaçanikut marrin pjesë këshilltarë të pesë partive politike PDK, AAK, LDK, AKR dhe LDD, duke numëruar 27 ulëse.

Përbërja e Kuvendit

- PDK 13
- AAK 7
- LDK 4
- AKR 2
- LDD 1

Komiteti për Politikë dhe Financa

Xhelal Gashi PDK
Zekrija Loku PDK
Arbnora Sallahu PDK
Kemajl Murseli PDK
Shukri Luta AAK
Shyqeri Luzha AAK
Daut Rudi LDK

INPO vlerëson se performanca e Kuvendit Komunal të Kaçanikut është jo e mirë. Diskutimet në përgjithësi mbesin jo në nivel profesional dhe përmbajnë retorikë politike. Për më tepër opozita nuk është duke e luajtur rolin e vetë të cilin e ka dhe me të cilin mund të kontribuoj në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, në kompetencë të Kuvendit të Komunës janë nxjerrja e rregulloreve të komunës, rregulloreve të punës dhe akteve tjera të nevojshme brenda fushë-veprimtarisë¹³. Për më tepër, Komuna është obliguar që të bëjë publikimin e transkripteve të seancave dhe të seancave plenare dhe përmbledhjen e rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera të miratuar. Publikimi i tyre është tashmë një praktikë e cila zbatohet nga disa Komuna, duke përfshirë edhe Ferizajn.

Në këtë drejtim, Kuvendi Komunal paraqitet si jo-transparent për arsye se në faqen zyrtare në internet nuk ka bërë publikim as të transkripteve të seancave plenare dhe as përmbledhjen e akteve të miratuara. Kjo paraqet shkelje të rregullave ligjore dhe zotimeve për transparencë, dhe gjithashtu paraqet pengesë për qytetarët dhe shoqërinë civile që të mund në mënyrë efektive të ushtrojnë kontrollin në Kuvendin Komunal.

Arsimi

Arsimi në Komunën e Kaçanikut është në gjendje të rëndë. Suksesi shumë i dobët në shkollë, mungesat e shumta dhe disiplina, mungesa e stafit mësimdhënësve të kualifikuar janë disa nga problemet me të cilat përballlet Komuna e Kaçanikut. Për më tepër, nga komunikimi i monitoruesve me personat përgjegjës nuk duket se ka ndonjë plan konkretë për adresimin e këtyre çështjeve.

Nga të dhënat e prezantuara nga Drejtoria e Arsimit në mbledhjet e Kuvendit Komunal, del se në Komunën e Kaçanikut nga 1850 nxënës, 62.8% kanë përfunduar gjysëmvetorin me 1-sha. Edhe pse ende nuk ka statistika për fundin e vitit shkollor, raportohet se përmirësimet nuk janë të mëdha. Ky është një sukses dëshpërues i nxënësve dhe i cili tregon për mos-funksionim të komplet sistemit arsimor në Komunë. Për më tepër ka probleme edhe sa i përket disiplinës së nxënësve dhe sigurisë në shkollë, mungesës së stafit mësimdhënësve të kualifikuar dhe tjera.

Përgjegjësia për këtë gjendje është e Drejtorisë së Arsimit e cila është përgjegjëse për shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunë, shkollave dhe stafit të mësimdhënësve. Nga përgjegjësia nuk mund të lirohen as nxënësit dhe prindërit të cilët duhet të kryejnë përgjegjësitë e tyre në marrëdhëniet me shkollën.

Trend negativ për arsimin në Kaçanik është edhe zvogëlimi i nxënësve të cilët regjistrohen në shkollë për herë të parë. Në bazë të dhënave të prezantuara në mbledhjet e Kuvendit Komunal nga ana e Drejtorisë së Arsimit në vitin 2010/2011 janë regjistruar 176 nxënës më pak në klasën e parë se në vitin paraprak. Shkaqet e këtij zvogëlimi ende nuk dihen saktësisht, a është numri i lindjeve apo emigrimi i popullsisë, megjithatë Komuna duhet ta adresojë urgjentisht këtë çështje, kjo për faktin se ulja e numrit të nxënësve ka pasoja negative afatgjata për zhvillimin e Komunës.

¹³LigjipërvetëqeverisjeLokale, neni 12, Kuvendi I Kosovës

Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë

Transparenca dhe llogaridhënia paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike në vendet demokratike dhe u referohen përgjegjshmërisë së një institucioni për punën të cilën e bëjnë. Në njërin anë institucionet duhet të informojnë publikun dhe të japin informatat tjera të kërkuara lidhur me punën e tyre, dhe në anën tjetër të argumentojnë rëndësinë, nevojën dhe ndikimin e vendimeve tyre. Në këtë mënyrë krijohet një sistem përmes të cilit qytetarët ndikojnë në ngritjen e kontrollit e cila rezulton në profesionalizëm të shtuar dhe përgjegjësi nga institucionet. Në Kosovë përdorimi i këtyre dy termave është deformuar nga përdorimi jo i drejtë i tyre dhe shndrimi i tyre në një retorikë politike.

Lidhur me këto dy parime Komuna e Kaçanikut ka probleme serioze. Kjo është e aplikueshme sidomos për llogaridhënien dhe rastin e Kryetarit, i cili elaborohet në kapitullin mbi Kryetarin e Komunës. Edhe sa i përket Transparencës në organet tjera komunale ato vazhdojnë të mos i përdorin mundësitë dhe sajtin zyrtarë për të plasuar informacionet e nevojshme për qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile. Andaj qasja në informacione dhe dokumente zyrtare mbetet përgjithësisht e vështirë, ku për qasje në to kërkohet të kalohet nëpër shumë mekanizma burokratike brenda Komunës.

Problemet me të cilat përballen komuna dhe qytetarët

INPO vlerëson se ndër problemet me të cilat ballafaqohen Kaçaniku dhe qytetarët e tij përfshijnë ndotjet e ambientit nga prodhuesit, gjendja e rëndë sociale, qasja e personave me aftësi të kufizuara në ambiente publike et.. Këto probleme të identifikuar, edhe pse nuk janë përgjegjësi ekskluzive e Komunës do të duhej të futeshin në agjendën e zyrtarëve Komunale dhe të adresoheshin së bashku me institucionet tjera përgjegjëse.

Gjendja sociale në Komunën e Kaçanikut paraqitet mjaft e rëndë. Problemi më i ndjeshëm në këtë drejtim mbete sigurimi i kushteve minimale për jetesë për të pastrehët. Përpos identifikimit nga INPO disa raste mjaft të rënda janë paraqitur edhe në media, raste ku paraqiteshin jetesa të familjeve në kushte ekstreme. Kjo edhe pse ata banorë kërkonin ndihmë nga Komuna për vite me radhe. INPO është e vetëdijshme se Komuna ka limite buxhetore por duhet të ndërmerri hapa konkretë për të gjetur zgjidhje për këta banorë.

Në anën tjetër, edhe shkalla e lartë e papunësisë paraqet një indikator për gjendjen e rëndë sociale. Kështu, me hapjen e vendeve të reja të punës në projektin e regjistrimit të popullsisë, proporcioni aplikantë-vende të punës ka qenë 7 aplikantë të cilët kanë aplikuar për 1 vend pune.

Ambienti jashtëzakonisht i ndotur në Komunën e Kaçanikut paraqet një shqetësim të madh për qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Kaçaniku po ballafaqohet me ndotjen e të sferave jetësore: ujit, ajrit dhe tokës. Toka është ndotur shumë nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave dhe eksploatimi nga fabrika e gëlqeres e cila për më tepër ka shkaktuar edhe pluhur të madh. Në anën tjetër Lumi Lepenc i shndërruar në deponi plehrash dhe është ndotur shumë nga prodhuesi i tullave Silcapor i cili bën hedhjen e tepricave industriale në lum. Po ashtu edhe ajri paraqitet shumë i ndotur për shkak të funksionimit të fabrikës së gëlqeres dhe gjithë pluhurit të cilin e lëshon në atmosferë. Edhe pse Komuna ka ndërmarrë hapa të vegjël dhe ka ndëshkuar me shuma simbolike është shumë e nevojshme që të ndërmerren hapa më radikalë në mbrojtje të ambientit.

Objektet publike në Komunën e Kaçanikut nuk ofrojnë mundësi për qasje në to nga personat me aftësi të kufizuar. Për më tepër në tryezë e organizuar nga HANDIKOS lidhur me këtë temë u prezantuar se nga 13 objekte të inspektuara 9 prej tyre nuk ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuar. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të Ligjit për Ndërtim të Kosovës i cili kërkon që për objektet publike, dhe ato të cilat janë për përdorim nga shumë persona të ofrohen të gjitha kushtet për qasje pa problem nga personat me aftësi të kufizuar.

Shqetësim për qytetarët paraqet edhe mirëmbajtja e parkut të qytetit. Ky park paraqet ndër hapësirat e pakta të gjelbërta dhe të rregulluara brenda qytetit të Kaçanikut. INPO e vlerëson qëndrimin e Komunës lidhur me këtë dështim, me të cilin rast Komuna e pranon përgjegjësinë dhe premtën se do ta adresojë këtë problem.¹⁴

¹⁴“Parkunukmirëmbahet, Komuanpranonpërgjegjësinë”, GazetaKohaDitore, 3 Prill 2011, verzioniprintuar, faqe 14.

Komuna e Shtimes

Komuna Shtime

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në koordinatat 00.00. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të Kosovës. Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore dhe bujqësia është një nga prioritetet zhvillimore të komunës.¹⁵

Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina), 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale, këtë segment duhet ruajtur dhe zgjeruar në mënyrë që të ruhet ky avantazh për zhvillim ekonomik dhe tregtarë.¹⁶

Kryetari i Komunës

Institucioni i Kryetarit të Komunës ka përgjegjësi të mëdha në mirëfunksionimi e Komunës dhe funksionalizimin e shumë mekanizmave që janë cilësi e qeverisjes demokratike dhe transparente dhe e cila përmbush pritjet e qytetarëve. Duke pasur këto përgjegjësi dhe duke qenë se zgjidhet drejtpërdrejt nga votat e qytetarëve shpeshherë kryetari shihet nga qytetarët si adresa përgjegjëse për kritika apo arritje lidhur me pritjet e qytetarëve.

Pozita e Kryetari të Komunës së Shtimes ushtrohet nga ana e z. Naim Ismajli, i cili është zgjedhur në raundin e parë të zgjedhjeve me 15 Nëntor. Zgjedhja e tij në raundin e parë është tregues i besimit të lartë të qytetarëve dhe pritjeve për realizimin e projekteve të premtuar.

INPO e vlerëson qeverisjen e Z. Naim Ismajli si një ndër qeverisjet e cila më së miri nga katër komunat në monitorim i ka përfshirë në punën e saj parimet e qeverisjes demokratike, duke përfshirë një qeverisje transparente dhe bashkëpunuese me qytetarë dhe shoqërinë civile dhe llogaridhënese. Problem serioz i kësaj qeverisje mbetet realizimi i projekteve dhe premtimeve të dhëna qytetarëve.

Komuna e Shtimes në aspekt të Transparencës dhe Llogaridhënies qëndron shumë më mirë se sa Komuna e Ferizajt dhe Kaçanikut. Qasja në informacion dhe dokumentacion qoftë për mediet apo shoqërinë civile është shumë më e lehtë. Për më tepër kryetari Ismaili mban një komunikim më të rregullt me qytetarë dhe takime më të shpeshta duke i marr parasysh propozimet e qytetarëve për projektet kapitale dhe investimet e ndryshme.

Zyra e Informimit të kësaj Komunë është funksionale dhe në nivel të kënaqshëm. Ka një faqe elektronike mjaft të pasur me informacione dhe freskohet në përditshmëri.

Edhe sa u përket drejtorive, drejtorët tyre dhe udhëheqësit e të gjithë sektorëve kanë një komunikim të mirë me mediet dhe shoqërinë civile. Kjo është një fakt i cili është vërejtur edhe gjatë monitorimit të INPO-s.

¹⁵ Komuna Shtime, sajti zyrtarë, i disponueshëm në: <http://kk.rks-gov.net/shtime/City-guide/Geography.aspx>

¹⁶Ibid.

Realizimi i premtimeve të Kryetarit

Kjo pjesë e raportit vlerëson realizimin e premtimeve të Kryetarit të Komunës lidhur me projekte dhe investime të ndryshme. Këto premtime janë përmbledhje e monitoruesve të INPO-s bazuar në deklaratat dhe premtimet publike të dhëna nga kryetari Ismaili, sidomos gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2009.

Premtimet	Vlerësimi
Transparencë dhe shpenzim efikas të fondeve publike	3
Për fshatin Zborc : ujësjellësin, asfaltimin e rrugëve të mbetura dhe një fushë sportive	2
Zhvillim ekonomik dhe përkrahje në bujqësi, veçanërisht mbështetje të fermerëve përmes subvencionimit nga komuna dhe qeveria	4
Ambient më të pastër	3
Ndërtimin e një mini hidrocentrali prej 60 M	
Për fshatin Belincë: ndërtimin e rrugës dhe të kanalizimit, si dhe ndërtimin e shkollës së re	1
Për fshatin Reçak: asfaltimin e çdo rrugice dhe vendosjen e kanalizimit	3
Përfundimin e Kompleksit Përkujtimor të Reçakut	2
Përfundimin e palestrës së sportit në tetor 2010, dhe 3 fusha të tjera sportive (Shtime, Godanc, Davidovc) në vlerë prej 2, 220 milion euro	4
Ndërtimin e rrugës unazë, e cila tashmë një segment e ka të përfunduar	3
Për fshatin Gjurkovc: ndërtimin e një objekti të ri shkollor dhe kanalizimin e fshatit	2
Për fshatin Muzeqinë: ndërtimin e një rezervuari për furnizim me ujë të pijshëm, ndërtimin e një shkollë të re, asfaltimin e rrugicave, rregullimin e kanalizimit dhe një zyre administrative	2

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.

- 0- tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
- 1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,
- 2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,
- 4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe
- 5- Tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.

Kuvendi i Komunës

Struktura ligjore në Kosovë parashikon se Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.¹⁷ Anëtarët e Kuvendit, të cilët janë të zgjedhurit e qytetarëve kanë në dispozicion mjete të ndryshme për të përfaqësuar interesat e tyre dhe të për mbajtur përgjegjësis Komunën. Ndër ta përfshihen kompetencat e tyre për miratimin e shumë akteve të ndryshme dhe buxhetit, pastaj të drejtën për të kërkuar pyetje dhe kërkuar informacione shumë nga Kryetari dhe Ekzekutivi i Komunës. Përmes këtyre mekanizmave mund të arrihen rezultate të mira në qeverisje

Kuvendi komunal në Shtime numëron 21 ulëse, të cilat plotësohen nga këshilltarët e partive politike. Aktualisht në përbërjen e Kuvendit komunal kemi këtë ndarje në bazë të votave që kanë arritur ti marrin gjatë zgjedhjeve 2009.

Përbërja e kuvendit

- PDK
- LDK
- AAK
- AKR
- LDD

Komiteti për Politikë dhe Financa

Kujtim Xhelili PDK
 Nerxhivane Azizi PDK
 Brahim Isufaj PDK

 Minire Qorolli PDK
 Ahmet Ahmeti LDK
 Nazmi Shahini LDK
 Shaban Halimi LDD

INPO e vlerëson lartë nivelin e diskutimeve në Kuvendin Komunal në Shtime. Diskutimet në të shumtën e rasteve janë profesionale dhe nuk kalojnë në nivel personal. Për më tepër ka bashkëpunim të mirë dhe konstruktiv mes pozitës dhe opozitës, bashkëpunim i cili ka rezultuar rezultate më të mira të punës. Si mangësi të punës në Kuvend INPO vlerëson mungesën e vizionit dhe plan-programeve të qarta mbi synimet e asamblistëve. Kjo si shkak i mungesës së profilizimit të partive politike dhe mungesës e një filozofie qeverisëse.

¹⁷LigjipërVetëqeverisjeLokale, neni 35, Kuvendi I Kosovës

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, në kompetencë të Kuvendit të Komunës janë nxjerrja e rregulloreve të komunës, rregulloreve të punës dhe akteve tjera të nevojshme brenda fushë-veprimtarisë¹⁸. Nga një krahasim i INPO-s del se Kuvendi Komunal i Shtimes është një prej Kuvendeve më aktive nga të katër komunat e paraqitura në këtë raport, si për nga numri i akteve të miratuar ashtu edhe për nga fushat të cilat rregullohen përmes këtyre akteve.

Aktet e nxjerra të Kuvendit Komunal në shtime përfshijnë:

Rregulloret Komunale të miratuara gjatë periudhës Janar - Qershor 2011
Plani i veprimit rinor lokal 2011-2013 shtime
Për caktimin e orarit të punës në lëmin e tregëtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në komunën e shtimes
Rregullore për ndarjen e bursave për studentë

Vendimet e Kuvendit të Komunës për periudhën Janar - Qershor 2011
Për aprovimin e subvencioneve sipas buxhetit të vitit 2011
Për caktimin e orarit të mbledhjeve të komitetit për komunitete për vitin 2011
Për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të kuvendit komunal/
Për mosaprovimin e propozim-vendimit për caktimin e mëditjeve për anëtarët e kuvendit, komiteteve dhe komisioneve
Për adresimin e kërkesave të qytetarëve
Për aprovimin e kërkesës të drejtoris për ekonomi dhe financa
Për zgjedhjen e komisionit komunal për vlerësimin
Për zgjedhjen e kryesuesit të komitetit për shërbime publike
Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të komitetit për politikë dhe financa për vitin 2011
Për plotësimin e titullit të vendimit për zgjedhjen e komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të luftës
Për ta nxjerrë në diskutim publik
Për aprovimin e raportit financiar për vitin 2010
Për aprovimin e planit të veprimit rinor lokal
Për ndryshimin e rregullores të kuvendit komunal – shtime 01nr.197-3, datë:30.9.2003 për caktimin e orarit të punës në lëmin e tregëtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në komunën e shtimes
Për refuzimin e kërkesës, 01nr.07/239
Për refuzimin e kërkesës, 01nr.07/228
Për refuzimin e kërkesës, 01nr.07/251
Për refuzimin e kërkesës, 01nr.07/142
Për refuzimin e kërkesës, 01nr.07/237
Vendim për ndërrimin e dy anëtarëve të komitetit për politikë dhe financa
Vendim për aprovimin e marrveshjes për themelimin e axhensionit për zhvillim rajonal-zona ekonomike qendër

¹⁸ LigjipërvetëqeverisjeLokale, neni 12, Kuvendi I Kosovës

Arsimi

Arsimi në Shtime ka probleme të ngjashme me problemet në arsim të prezantuar për Komunën e Ferizajt dhe tëKaçanikut. Ato përfshijnë cilësinë e arsimit, sigurinë dhe mungesën e kushteve. Veprim mjaft pozitiv për arsimin në Shtime është ndarja e bursave për studentë, edhe pse simbolike (50 euro në muaj), nga ana e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kjo e bënë këtë të vlefshme për faktin se Komuna e Shtimes ka një buxhet shumë të limituar dhe shumë më të vogël në krahasim me Komunën e Ferizajt dhe tjera.

Transparenca, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë

Qeverisja lokale në Shtime ka treguar disa rezultate impresionuese sa i përket dy fushave, realizimi i taksave Komunale dhe themelimi i instrumenteve të ri të decentralizim të vendimmarrjes për të arritur sa më afër qytetarëve. Në njërën anë, realizimi i tatimit në pronë për vitin 2010 ka qenë 116% të planifikimit. Edhe të ardhurat nga tatimet për vitin 2011 janë të kënaqshme dhe tregojnë se Komuna do të arij të përmbush planifikimin për të hyra deri në fund të vitit.

Komuna e Shtimes paraqet shembullin më të mirë të zbatimit të nenit 34 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që paraqet edhe një prej qëllimeve kryesore të funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Neni i lartë përmendur i autorizon Komunitat që të mund të lidhin me fshatrat në mënyrë që tu përgjigjen interesave të qytetarëve sa më afër. Ky paraqet një ndër rastet e shumë të rralla të realizimit të këtij mekanizmi në Kosovë.

Problemet me të cilat përballen Komuna

Një ndër problemet më serioze me të cilat përballen qytetarët e Komunës së Shtimes paraqet gjendja e rëndë sociale. Gjendja sociale në Komunën e Shtimes paraqitet mjaft e rëndë. Problemi më i ndjeshëm në këtë drejtim mbete sigurimi i kushteve minimale për jetesë për të pastrehët. Kjo është identifikuar edhe nga raportimet e medieve të shkruara. Komuna në këtë drejtim nuk ka arritur të ju ndihmojë këtyre banorëve për një kohë të gjatë.

Komuna e Hanit të Elezit

Komuna Hani i Elezit

Hani i Elezit me rrethinë shtrihet në pjesën më jugore të Republikës së Kosovës, në kufij me Republikën e Maqedonisë. Ky vendbanim është ngritur në të dy anët e lumit Lepenc në dalje të Grykës së Kaçanikut dhe ka një sipërfaqe prej 8294 ha, 18 ari, 92 m. Në mbështetjen e të dhënave të shumta nga janari i vitit 1913 në rrethin e Kaçanikut ishin formuar katër komuna njëra prej të cilave ishte edhe komuna e Hanit të Elezit, me 1093 banorë. Kryetari i parë i komunës së Hanit të Elezit ishte Fejzë(Fejzulla) Bushi. Pra Komuna e Hanit të Elezit daton që nga viti 1913.¹⁹

Kryetari i Komunës

Posti i Kryetarit të Komunës në Han të Elezit ushtrohet nga zoti Rufki Suma. Z. Suma është kandidati i vetëm i pavarur i cili ka arritur të fitojë zgjedhjet lokale në një Komunë. Kjo edhe përkundër faktit se kandidatët të cilët vinin nga partitë politike kishin përkrahje financiare dhe logjistike. Andaj, Hani i Elezit paraqet një shembull të shkëlqyer të kulturës së lartë qytetare në votim dhe forcës së individëve për të bërë ndryshime.

INPO vlerëson se Komuna e Hanit të Elezit paraqet një shembull suksesi lidhur me transparencën, llogaridhënien, bashkëpunimin me qytetarë dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Probleme me qeverisjen e z. Suma ka sa i përket shfrytëzimit efikas të buxhetit.

Një prej karakteristikave të qeverisjes në Han të Elezit është lidhja shumë e mirë e Komunës me qytetarë. Kjo është treguar në disa raste, duke përfshirë mbrojtja dhe përkrahja e protestave të punëtorëve të ndërmarrjes së privatizuar “Sharrcem”. Kjo përkrahje nuk ka mbetur vetëm retorikë politike por si kryetari ashtu edhe asambleistët e Kuvendit Komunal janë angazhuar me veprime konkrete. Për më tepër angazhimi i z. Suma është shtrirë edhe në përkrahje të qytetarëve individual, dhe kjo është dëshmuar në rastin e keqtrajtimit të të riut nga kjo Komunë në kufi. Është për tu përshëndetur veprimi i tij i cili menjëherë kontakton ambasadorin maqedonas.

Në fushën e llogaridhënies ka pasur verime të cilat kanë treguar për një sistem të përgjegjësisë, por janë veprime nga të cilat nuk mund të gjeneralizohet dhe konkludohet lidhur me llogaridhënien në përgjithësi. Organizata INPO përmes një shkrese zyrtare të adresuar Kryetarit të Hani të Elezit zotëri Rufki Suma, ka kërkuar që tu shqiptohet masa ndëshkimore, Shkarkim nga detyra, Këshilltarit të tij Mallzum Çajani dhe Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit Nexhmedin Daci, kërkesën e mbështetur në arsyetimin se këta kanë bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe parimeve themelore etikës së punës dhe atyre profesionale. Reagimi i z. Suma ka qenë me shkarkimin e menjëhershëm të z. Nexhmedin Daci.

¹⁹Komuna Hani i Elezit, sajti zyrtarë, i disponueshëm në: <http://kk.rks-gov.net/hanielezit/City-guide/History.aspx>

Hani i Elezit ka performancë shumë të mirë sa i përket inkasimit të hyrave vetanake. Inkasimi i të hyrave vetjake premtues, kjo pasi vetëm në tremujorin e parë të vitit 2011, Komuna ka arritur që të vjelë 27.9% të të hyrave të parapara.²⁰

Problem i Hanit të Elezit paraqet shpenzimi i buxhetit, ku mbi gjysma e tij shkon për paga dhe mëditje. Në anën tjetër pak më shumë se gjysma e shumës së pagave dhe mëditjeve shkon në investime kapitale, që janë baza e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe ngritjes së mirëqenies. Në figura, buxheti i vitit 2010 është 1 424 022 euro, prej të cilave paga dhe mëditje 747 834 aga dhe mëditje, mallra dhe shërbime 184 934, derisa investime kapitale 435 292 euro.

Edhe pse me këtë gjendje, Hani i Elezit vendos ti shtoj edhe dy drejtorate të reja, duke e ngritur qeverisjen lokale në një vend me rreth dhjetë mijë banorë në 8 dikastere. Ndryshimet në skemat organizative dhe funksionale të komunës do të duhej të reflektonte nevojat e vërteta të komunës dhe qëllime të qarta se çfarë synohet të arrihet nga ndryshime të tilla, dhe kjo së bashku me analizë të efekteve buxhetore të cilat i ka. Në rastin e Komunës së Hanit të Elezit, INPO e ka pasur të pamundur të siguroj informacionin mbi studimet e fizibilitetit apo analiza tjera mbi nevojën dhe implikimet nga krijimi i këtyre drejtorive shtesë. Ajo çfarë sigurisht dihet se buxheti do të ngarkohet edhe më tepër në fushën e pagave dhe mëditjeve.

Kuvendi i Komunës

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit përmes veprimeve të ndërmarrura ka treguar se është në mbrojtje të interesit të qytetarëve dhe interesit publik. Në këtë linjë është edhe vendimi Asamblesë për ta paditur AKP për privatizimin e “Sharrcem”. Kjo pas shprehjes së pakënaqësive nga ana e qytetarëve dhe të dhënave për manipulime me rastin e privatizimit. Ky paraqet një rast i cili duhet shërbej si shembull edhe për Komunitat tjera, mbi atë se organet komunale duhet të kenë rol aktiv në mbrojtje të interesit të përgjithshëm.

Përkundër INPO vlerëson aktivizimin e Kuvendit Komunal, sjellja e disa asamblistëve dhe niveli i diskutimeve në disa raste është për çdo kritikë. Nuk janë të rralla rastet që në Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit ndodhin incidente dhe përdoret gjuhë jo parlamentare nga ana e anëtarëve të kuvendit dhe ekzekutivit. Diskutimet në kuvend shumicën e herëve kalojnë në rrafshin personal dhe nuk ka konstruktivitet dhe diskutim profesional të pikave të rendit të ditës.

E tërë kjo ka kulmuar me konflikti verbal mes këshilltarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Zylbehar Hasallari dhe inspektorit të tregut z. Fari Shkreta, i cili konflikt tejkalon çdo normë të sjelljes profesionale dhe etikës së punës.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, në kompetencë të Kuvendit të Komunës janë nxjerrja e rregulloreve të komunës, rregulloreve të punës dhe akteve tjera të nevojshme brenda

fushëveprimtarisë²¹. Për më tepër, Komuna është obliguar që të bëjë publikimin e transkripteve të seancave dhe të seancave plenare dhe përmbledhjen e rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera të

²⁰“Inkasim premtues në Hanin e Elezit”, Epoka e Re, 15 Prill 2011, version printuar, faqe 11

miratuar. Publikimi i tyre është tashmë një praktikë e cila zbatohet nga disa Komuna, duke përfshirë edhe Ferizajn, Shtimen dhe tjera.

Në këtë drejtim, Kuvendi Komunal paraqitet si jo-transparent për arsye se në faqen zyrtare në internet nuk ka bërë publikim as të transkripteve të seancave plenare dhe as përmbledhjen e akteve të miratuara. Kjo paraqet shkelje të rregullave ligjore dhe zotimeve për transparencë, dhe gjithashtu paraqet pengesë për qytetarët dhe shoqërinë civile që të mund në mënyrë efikase të ushtrojë kontrollin në Kuvendin Komunal.

Kuvendi komunal në Han të Elezit, numëron 15 asamblistë, kjo në përputhje me nenin 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili ligj numrin e asamblistëve e përcakton në raport me numrin e banorëve. Aktualisht në përbërjen e Kuvendit komunal kemi këto parti politike, në bazë të votave që kanë arritur ti marrin gjatë zgjedhjeve 2009:

Përbërja e kuvendit

- PDK
- LDK
- AAK

Komiteti për Politikë dhe Financa

Drita Curri LDK
Qamush Brava LDK
Mirsad Shkreta PDK
Shaban Cupi PDK

Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura

Një prej të arriturave të qeverisjes lokale në Han të Elezit është koordinimi me institucione të ndryshme dhe mundësia për të përfituar fonde për investime në projekte kapitale. Kështu, investimet në projekte kapitale në Han të Elezit kapin vlerën prej mbi tre milionë euro. Financohen nga Ministria Infrastrukturës, Komisioni Evropian, UN-Habitati, dhe të hyrat vetjake të Komunës. Projektet përfshijnë përfundimi i rrugës Hani i Elezit – Gorancë, shtrimi me asfalt i rrugës Hani i Elezit Paldenicë, rregullimi i sheshit të qytetit dhe kanalizimit të fshatit Paldenicë.

²¹LigjipërvetëqeverisjeLokale, neni 12, Kuvendi I Kosovës

Arsimi

Arsimi në Komunën e Hanit të Elezit gjatë kësaj periudhe nuk ka shënuar ndonjë përparim dhe nuk është ndërmarrë ndonjë masë për të adresuar gjendjen me të cilat po përballet. Cilësia në arsim mbetet brenga më e madhe. Cilësinë shumë të dobët të arsimit në këtë komunë e tregojnë disa indikatorë, duke përfshirë kualifikimet e mësimitdhënësve, notënn mesatare të studentëve dhe suksesin në testin e maturës.

Sa i përket përgatitjes akademike të mësimitdhënësve të dhënat flasin se njëqind (100) mësimitdhënës janë të pakualifikuar, që përkthehet në 25% të gjithë mësimitdhënësve të Komunës. Në anën tjetër 36% të mësimitdhënësve janë me përgatitje joadekuate për lëndët të cilat i ligjërojnë. Këto të dhëna janë shqetësuese pasi nëse ligjëruesit nuk janë me përgatitje adekuate nuk mund të ketë pritje edhe për cilësinë e nxënësve.

Sa i përket suksesit të nxënësve, ai nuk është i mirë. Sa i përket notimit dhe rezultateve ka dyshime në objektivitetin e notimit, kjo nëse krahasohet notat e gjysmë-vjetorit me notat përfundimare dhe rezultatet në testin e maturës. Kështu sukcesi i përgjithshëm në shkollën e meseme Dardania është me notë mesatare 3.44 ndërsa në tri shkollat fillore nota mesatare është 3.86. Në anën tjetër kalueshmëria në testin e maturës shtetërore për shkolla të mesme për shkollën e mesme eDardania ishte vetëm 23.05%, prej përqindjeve më të ulëta në nivel Komunash.

Shëndetësia

Sistemi shëndetësor në Komunën e Hanit të Elezit si sfida kryesore ka mungesat në kapacitete njerëzore dhe kapacitet infrastrukture. Në tërësi, në komunë ka vetëm gjashtë (6) mjek te përgjitheshe, një stomatolog, një kryeinferimer. Edhe pse është premtuar se komuna do të angazhoj edhe specialistë tjerë të mjekësisë por asgjë nuk është bërë ende. Komuna ka shumë nevojë për internist, gjinekolog, pediatër. Në anën tjetër Hani i Elezit përballet edhe me mungesë të hapësirave për kujdesin shëndetësor dhe mungesë e aparatures mjekësore. Për shërbime të ndryshme qytetarët duhet të drejtohen në komunat tjera, kështu dy pacienty të cilët duhet ti trajtohen hemodializës duhet të udhëtojnë për në Ferizaj apo komuna tjera.

Rreth INPO-s

INPO është themeluar në vitin 2005 duke realizuar aktivitete që kanë ndihmuar integrimin e qytetarëve në proceset sociale dhe vendimmarrëse. Pas disa viteve punë efektive, duke e parë të rëndësishme profilizimin e INPO-s, kemi përcaktuar tri programe si bazë e angazhimeve të INPO-s: Programi për transparencë dhe llogaridhënie, Programi për Avokim, dhe Programi për Integrim Evropian.

Pjesë e stafit të INPO-s janë individë që kanë arritur të dëshmojnë entuziazëm, përkushtim dhe seriozitet në punën e tyre e që është reflektuar në profesionalizmin dhe kredibilitetin e organizatës. Në mbështetje të konsultimeve dhe disiplinës në punë; përmes performancave artistike protestuese, debatit, fushatave të avokimit, kemi arritur të ndryshojmë strategjitë dhe rregulloret jo-funksionale të institucioneve qeveritare lokale. Më tutje, ne kemi fituar respektin dhe besimin e qytetarëve duke ndërmjetësuar dhe lehtësuar në zgjidhjen e problemeve ose konflikteve administrative me qeverinë lokale.

Përgjatë pesë viteve të punës intensive ne kemi ndërtuar raport të shkëlqyeshëm me mediat si dhe partneritet me organizata të ndryshme, duke qenë anëtar të disa rrjeteve të rëndësishme në Kosovë. Ne, synojmë që në të ardhmen të jemi edhe pjesë e rrjeteve rajonale si dhe të vazhdojmë raportet e mira me partnerët aktual. Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike, përbëjnë aspektin më të suksesshëm të punës së organizatës për tri vitet e fundit. Ne synojmë të jemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimtarisë.

Organizata udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka 3 anëtarë dhe takohet në baza të rregullta javore. Gjithashtu organizata ka edhe Bordin Konsultativ, i cili përbëhet nga personalitete të respektuara dhe aktiv në jetën publike. www.inpo-ks.org

PROJEKTI I MONITORIMIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT, KAÇANIKUT, SHITES DHE
HANIT TË ELEZIT DHE PUBLIKIMI I KËTIJ RAPORTI ËSHTË PËRHRAHUR NGA:

NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world



Rr/Str: Ahmet Kaçiku nr.35
kati V, 70 000 Ferizaj

Tel.+381(0)290 329 400

info@inpo-ks.org

www.inpo-ks.org